



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.7.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 19.7.2019, mbi analizën ekonomiko-financiare paraprake të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për periudhën gusht 1995 – 4.9.2006, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Nertina Kosova

I nderuar kryesues,

të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioneri Publik, pasi vlerësoi analizën ekonomiko-financiare paraprake, të vënë në dispozicion nga ana e këtij trupi, në seancën e datës 12.7.2019, konstaton si vijon:

- Analiza financiare është kryer për njësinë ekonomike familjare Kosova me katër persona, sipas kërkesës së Komisionerit Publik, bazuar në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e saj për këtë periudhë janë dorëzuar në familje dhe janë administruar nga i ati në cilësinë e kryefamiljarit, së bashku me të ardhurat e tjera familjare, për periudhën gusht 1995 – 4.9.2006;
- Nga përmbajtja e kësaj analize, në zërin “të ardhura”, janë përfshirë të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, në referencë të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës. Në zërin “shpenzime”, janë përfshirë shpenzimet e identifikuar të kryera nga familja Kosova për periudhën gusht 1995 – 4.9.2006, siç janë shpenzimet për blerje automjeti, pagesë kësti për shoqërinë “****.***” sh.p.k, shpenzime për qira dhe shpenzime për udhëtime jashtë shtetit;
- Në zërin “kursime” janë marrë në konsideratë gjendja në llogaritë bankare dhe ndryshimet në to, në emër të subjektit, babait, nënës dhe vëllait.

Nisur nga sa më lart, Komisioneri Publik shprehet dakord për këtë pjesë me metodologjinë e përdorur për këtë analizë, zërat e marrë në konsideratë dhe rezultatet respektive.

Ndërkohë konstatohet se në zërin “shpenzime jetese”, analiza financiare, e paraqitur nga ky trup gjykues, është kryer në tri variante:

- Varianti I, ku shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur me 66% të të ardhurave familjare deri në datë 31.12.2002, ndërsa pas periudhës 1.1.2003 e në vijim janë bazuar në përlllogaritjet e kryera nga Komisioni;
- Varianti II, ku shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas metodologjisë së ILDKPKI-së (referuar shkresës së ILDKPKI-së nr.*** prot., datë ***.3.2019);

- Varianti i III, ku shpenzimet e jetesës janë llogaritur me 66% të të ardhurave familjare deri në datë 31.12.2002, ndërsa për periudhën 1.1.2003 e në vijim, janë bazuar në të dhënat e shpenzimeve mujore për konsum, sipas madhësisë së njësisë ekonomike familjare (NJEF), referuar të dhënave mbi “*Shpenzimet mujore për konsum sipas qarqeve*”, publikuar nga INSTAT, e përllogaritur në bazë të inflacionit sipas Indeksit të Çmimeve të Konsumit, publikuar nga INSTAT. Për vitet kur INSTAT-i nuk ka publikuar të dhëna, kostot e jetesës janë përllogaritur me të dhënat e vitit pasardhës, përfshirë inflacionin në ndryshimet mesatare vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Komisioneri Publik çmon të nevojshme të parashtrojë përpara trupit gjykues, se në shqyrtimin e akteve të vendimeve të Komisionit, që i janë njoftuar deri më tani IKP-së, vlerësimi ynë është bazuar në metodologjinë financiare që është përdorur nga ky institucion, pra Komisioni, e që përkon me variantin I dhe II të analizës ekonomiko-financiare paraprake, që na është vënë në dispozicion.

Në të tilla kushte, rezultatet e këtyre dy varianteve të analizës (varianti I dhe II) i konsiderojmë të mjaftueshme për të lejuar Komisionerin Publik të dalë në përfundime për kërkimet e tij, duke ruajtur të njëjtin standard vlerësimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA